

Emri i Lëndës : Gjuhë Shqipe për të Huajt II							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
AFL 102	C	Pranverë	3.00	0.00	0.00	3.00	5.00
Lektori		Rahim Ombashi, Prof. Asoc. Dr.					
Asistenti							
Gjuha e kursit		Anglisht					
Niveli i lëndës		Bachelor					
Përshkrimi		Kursi me ligjërata synon t'u japë studentëve njohuritë më kryesore për të lexuar dhe për të folur gjuhën shqipe letrare për ata që e kanë shqipen gjuhë të nënës, por edhe për ata që duan që ta mësojnë shqipen, duan të lexojnë dhe të flasin shqip. Gjuha është një element shumë qendror në jetën e njeriut. Ajo ndihmon si realizimin e komunikimit, ashtu edhe formësimin e mendimit dhe transmetimin e tij. Për këtë arsye, një përdorim i saktë dhe sa më i mirë i gjuhës ndihmon si në procesin e njohjes, ashtu edhe në vetë prezantimin e personalitetit tonë. Ky kurs synon edhe t'i aftësojë studentët me një përdorim korrekt dhe sa më të plotë të shqipes, të përmirësojë aftësitë e tyre në të folurit dhe shkrimin e shqipes, por dhe t'i ndihmojë në ndërtimin e një ligjërimi të rrjedhshëm dhe krijues.					
Objektivat		• Studenti të njihet dhe të aftësohet praktikisht me rregullat themelore të artit të të shkruarit në gjuhën e lashtë shqipe. •Të përvetësohen çështje të normës morfologjike dhe sintaksore. •Të arrijnë studentët një akt të lartë komunikativ, nëpërmjet ligjëritimit normativ. •Të bëjnë punime me nivel të lartë gjuhësor (ese, detyra kursi dhe punim diplome). •Të nxitet të vështruarit kritik dhe akti i korrektimit në rastet e shmangieve nga shqipja standarde.					
Konceptet Kryesore		1. shtimi i fjalorit (përkthimi) dhe shkrimi i krijimit; teksti; koherenca, kohezioni në gjuhën shqipe 2. rishikimi i materialit: redaktimi, korrektimi 3. gjuha standarde, pastërtia e leksikut, shmangiet nga standardi, pastrimi nga huazimet e panevojshme 4. supletiviteti i foljeve (të parregullta; dysorët) ... etj., dukuri të gjuhës shqipe. Pas përfundimit të skedimit të literaturës së planifikuar, pasi lexojmë skedat me mendime të vjela, fillojmë nënvizimin dhe shënimet, bëjmë sistemimin në përputhje me planifikimin e bërë më herët. Çdo shkrim përbëhet nga hyrja, zhvillimi dhe përfundimet. Lidhen të trija pjesët në mënyrë të natyrshme, sepse ligjërimi duhet të jetë i lidhur. Formohet kështu paragrafi, që më së shpejti lidhet me të tjerë, duke formuar njësinë që quhet tekst. Qoftë paragraf, artikull apo një libër i tërë ka kohezion dhe koherencë, që lidhen me organizimin gramatikor dhe atë logjik.					
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Mësimi i gjashtëmbëdhjetë Letër nga djali (tekst) Gramatikë: emrat e nyjshëm Përemri pronor Ushtrime Fjalë të urta Fjalë fluturake: 165-170.						
2	Mësimi i shtatëmbëdhjetë Gjenerali (tekst) Gramatikë: Foljet kalimtare dhe jokalimtare Ushtrime Lepuri te dentisti: 170-174.						
3	Mësimi i tetëmbëdhjetë Në restorant “Linza” (tekst) Gramatikë: Përemri vetor, lakimi, trajtat e shkurtra Përemri pyetës Ushtrime: 176-180.						
4	Mësimi i nëntëmbëdhjetë Në bar “Vjena” (tekst) Gramatikë: Përdorimi i trajtave të shkurtra Formim fjalësh Ushtrime Fjalë të urta: 181-186.						
5	Mësimi i njëzetë Bisedë prindërisht (tekst) Gramatikë: Koha e kryer e thjeshtë Lakimi i përemrave pronorë Përshtatja emër + përemër Valle labërishte: 187-194.						
6	Mësimi i njëzetënjë Erdhi daja në Korçë (tekst) Gramatikë: formimi i kohëve të shkuara të foljeve Format e pashtjelluara Ushtrime: 195-201.						

7	Mësimi i njëzetedytë Dasmë në Shkodër (tekst) Gramatikë: Mënyra dëshirore Lidhëza në... Ushtrime: 202-208.
8	Provim gjysmëfinal.
9	Mësimi i njëzetetretë Borë në Tiranë (tekst) Gramatikë: Mënyra habitore Ushtrime: 209-214.
10	Mësimi i njëzetekatërt Bisedë miqsh (tekst) Gramatikë: Mënyra kushtore Lidhëza kushtore Ushtrime: 215-222.
11	Mësimi i njëzetepestë Nëna (tekst) Gramatikë: Format e pashtjelluara të foljes Pjesorja: 223-230.
12	Mësimi i njëzetegjashtë Kush vjen pa ftuar, e gjen pa shtruar (tekst) Gramatikë: Forma e pashtjelluar mohore Paskajorja Ushtrime: 231-236.
13	Mësimi i njëzeteshtatë Mësimi i njëzetetetë Urdhri i drejtorit (tekst) Gramatikë: Mënyra urdhërore Vendi i përcaktorëve në sintagmë Ushtrime: 237-248.
14	Mësimi i njëzetënëntë Mësimi i tridhjetë Kruja (tekst) Mbresa nga Apolonia dhe Berati (tekst) Rendi i fjalëve Ushtrime: 249-258.
15	Pjesë leximi: 261-340.
16	Provim Final
Parakushtet Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.	
Literatura	
• Cikël leksionesh dhe materiale digjitale përmbledhur nga lektori i lëndës. (Ky cikël leksionesh është hartuar duke u bazuar si në literaturën e detyrueshme, ashtu edhe në atë të këshillueshme, pra është një përmbledhje e koncepteve themelore të lëndës). • Shkurtaj, Gjovalin & Hysa, Enver (2014) Gjuha shqipe për të huajt dhe shqiptarët jashtë Atdheut, BOTIM I RIPUNUAR, Tiranë: 165-434. • Thomas S. Kane, Si të shkruajmë shqip, Tiranë, 2010. • (1980) Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë: fjalori.shkenca.org;	
Referenca të tjera	
• Tahir N. Dizdari, Fjalor i orientalizmeve në gjuhën shqipe, Tiranë, 2005. • Ali Dhrimo-Rami Memushaj, Fjalor Drejtshkrimor i Gjuhës Shqipe, Tiranë, 2015. • Demiraj, Shaban. (1999) Prejardhja e shqiptarëve nën dritën e dëshmive të gjuhës shqipe, Shtëpia botuese "Shkenca", Tiranë; • Demiraj, Shaban. (1988) Gjuha shqipe dhe historia e saj, Tiranë: SHBLU: f. 247-276.	
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Përvetësimi i fjalëve dhe formave të fjalëve si dhe i rregullave gramatikore të gjuhës shqipe
2	Përvetësimi i elementeve gjuhësore për përdorim të përditshëm dhe në situata të ndryshme nëpërmjet teksteve specifike
3	Studentët do të jenë në gjendje të flasin rrjedhshëm dhe qartë në gjuhën shqipe si dhe të shkruajnë saktë
4	Nëpërmjet teksteve dhe pjesëve të leximit zhvillojnë të folurit me gojë dhe shkrim në gjuhën shqipe, por dhe mësojnë më tepër për Shqipërinë dhe shqiptarët.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	20	
Kuize	0	0	
Projekte	0	0	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	1	20	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			40
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			60
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	3	48
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	4	56
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	10	10
Provimi final	1	6	6
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			120
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			4.80
ECTS			5.00